



GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E PROJEKT BUXHETIT TE KOMUNES SE JUNIKUT  
PER VITIN 2025-2027

**Dëgjimi i parë buxhetor**  
**PROCESVERBAL**

Me datë 19.06.2024 duke filluar nga ora 14:00 u mbajt dëgjimi i parë buxhetor në sallën e Kuvendit Komunal. Takimin e hapi dhe moderoi Arten Hamza - Zyrtar Kryesor Financiar njëherit Kryesues i Grupit Punues i caktuar me vendim të kryetarit të komunës z. Ruzhdi Shehu.

Pasi përshëndeti dhe falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje Arten Hamza në dëgjimin e parë buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore për planifikimin e buxhetit për periudhën 2025-2027, fjalën ja kalon kryetarit të komunës i cili ishte prezent.

Kryetari z.Ruzhdi Shehu përshëndeti pjesmarrësit për prezencën dhe në veqanti përfaqësuesit e OSBE-së. Ai tregoi rëndësin e mbajtjes së këtij dëgjimi duke shprehur se këto kërkesa, sugjerime dhe ide të qytetarëve do të kontribuojnë në planifikimin sa më të mirë të buxhetit për vitet e ardhshme.

z.Arten Hamza luti pjesmarrësit të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes dhe të plotësojnë listën e propozimeve për projekte kapitale, në mënyrë që ato të mbeten të dokumentuar ku pastaj këto propozime do të përcjellen tek Këshilli i Drejtorëve dhe në Kuvendin Komunal të Junikut.

Pastaj filloi me prezantimin e dëgjimit të parë Buxhetor dhe tha: Bazuar në ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi është lëshuar Qarkorja e parë Buxhetore dhe e kemi pranuar me datën 15.05.2024 me numër 2025/01 ku janë përcaktuar kufijtë e financimit të të gjitha Organizatave Buxhetore. Pas pranimit të Qarkores së Parë Buxhetore Komuna e Junikut duhet që deri me datën 30.06.2024 ta përpiloj Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), ku aktualisht jemi të fazë të hartimit të saj, prandaj duhet të pranojmë edhe sugjerimet dhe kërkesat e juaja në mënyrë që të jetë sa më i plotësuar, dhe deri me 30 Qershor të dërgohet në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Pas aprovimit të KAB pason pranimi i Qarkorës së Dytë Buxhetore dhe do të vazhdohet me procesin e planifikimit të buxhetit për vitet 2025/2027.

Si grup punues i kemi planifikuar edhe 3 dëgjime të tjera buxhetore të rregullta, në muajin Korrik vetëm për gratë, në muajin Gusht për të gjitha grupet e interesit dhe në muajin Shtator gjithashtu për të gjitha grupet e interesit të cilën e organizon Komiteti për Politikë dhe Financa. Pas dëgjimeve publike deri në fund të shtatorit duhet të përmbyllet procesi i planifikimit të buxhetit dhe të prezentohen dhe aprovohen tabelat e buxhetit në Kuvend Komunal dhe pastaj të dërgohen në MFPT.

Qarkorja e parë buxhetore e pranuar me 15.05.2024 parasheh këtë buxhet për Komunën e Junikut:

Buxheti i përgjithshëm për 2025 është **2,340,143.00 €**, nga këto si burim financimi janë:

- Granti i përgjithshëm **1,182,544.00 €**
- Granti specifik për arsim **579,020.00 €**
- Granti specifik për shëndetësi **373,637.00 €** dhe
- Të hyrat vetanake **204,942.00 €**.

Nga këto të dhëna veq kemi filluar planifikimin preliminar të buxhetit ku janë bërë këto propozime:

- Paga dhe mëditje: **1,536,835.00 €**
- Mallëra dhe shërbime: **274,860.00 €**
- Shpenzime komunale: **42,950.00 €**
- Subvencione: **70,000.00 €**
- Invstime kapitale: **415,498.00 €**.

Këto shifra mund të ndryshojnë në kategoritë e shpenzimeve me lëshimin e qarkores së dytë buxhetore nga Ministria e Financave, mirëpo shuma e financimit prej **2,340,143.00 €** nuk do të ndryshoj. Në mënyrë që të bëjmë një shpërndarje sa më gjithpërfshirëse të shpenzimeve kapitale kërkohen propozimet e juaja. Prandaj ftoj të gjithë pjesmarrësit që të marrin fjalën dhe të shprehin interesat e tyre, qoftë për vitin 2025 apo për periudhën afatmesme 2025-2027.

Me kaq e mbylli prezantimin e tij kryesuesi i Grupit Punues z, Arten Hamza i cili më pastaj fjalën ua dha pjesëmarrësve për pyetje dhe propozime.

Kryetari i komunës z.Ruzhdi Shehu shprehi keqardhje që për shkak të shtyerjes së këtij dëgjimi publik ai kishte planifikuar një takim tjetër dhe duhet të merrte pjesë gjithsesi. Ai inkurajoi të gjithë pjesmarrësit të shprehin propozimet e tyre të cilat do të dokumentohen të gjitha me anë të Procesverbalit dhe Listës së Propozimeve me shkrim, ato do shqyrtohen edhe nga ana ime. Falenderoi të gjithë dhe kërkoi mirëkuptim që duhet të largohej.

Nga të pranishmit fjalën e mori z. Haxhë Qestaj dhe propozoi:

- Ndërtimi i kanalit të ujitjes segmenti Lagjja Goqaj – Arashaj - Janik, me gjatësi rreth 2 km

Për shkak të problemeve që po hasin banorët me bartjen e zhavorit dhe mbetjeve pyjore kërkohet që të shqyrtohet sa më shpejt kjo kërkesë.

z.Tafë Tofaj mori fjalën i cili propozoi:

- Ndërtimi i rrugës së Bjeshkës nga Prroi Shqiptar deri tek Zalli i Rupës.

Ai tha që është i nevojshëm ndërtimi i rreth 5 urave dhe rreth 4.5 km rrugë që duhet të mirëmbahet. Urat janë të shkatërruara nga reshjet e mëdha dhe kërkon intervenim të menjëhershëm. Ajo pjesë përveq qytetarëve të Junikut frekuentohet edhe nga turistët e shumtë. Për një intervenim më të shpejtë kostoja do ishte rreth 50,000 € ndërsa për periudhë afatgjate rreth 1,500,000 €

Propozim tjetër shprehu:

- Ndërtim i rrugës Malore prej Qafës së Jasiqit deri në Firza, rreth 5 km

Ai tha që është përgatitur një paramasë me ingjinerët e komunës dhe kosto do jetë rreth 30,000 €. Propozim tjetër tha:

- Trajtimi dhe spërkatja e pyjeve halore dhe gështenjave në Komunën e Junikut

z.Teki Krasniqi mori fjalën dhe propozoi këto projekte:

- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Shafrane dhe Luqe
- Kanalizimi i ujërave të zeza në lagjen Krasniqi rruga Shafrane
- Rregullimi i ndriqimit publik nga Pompa Zem-Zem deri tek rruga Bedri Shala

Ai tregoi që nga viti i ri jemi në mungesë të ndriqimit dhe po paraqet shumë problem ku për këtë është në dijeni edhe drejtori i Shërbimeve Publike.

Pastaj fjalën e mori z.Artan Krasniqi i cili pasi përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi Grupin Punues për punën, ai dha propozimet e tij:

- Ndërtimi i kanaleve të ujitjes lokacioni Arat e Mëdha – Errnica – Xhelat.

Ai tregoi që nga ky projekt përfitojnë banorët e lagjes Krasniq dhe Miroc me gjatësi rreth 2 km

Propozim tjetër dha:

- Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve

z.Imer Gjota pyeti nëse është e paraparë futja e kabllave të rrymës në tokë në segmentin e rrugës Restavicë – Qendra e Junikut, e cila ka filluar të punohet.

z.Zenun Shala tha që Komuna jonë do ta përgatis infrastrukturën e nevojshme dhe futjen e gypave në tokë dhe i mbetet KEDS-it të vendos kabllot e rrymës.

z.Arten Hamza propozoi që në takim me kryetarin të datës 24.06.2024 të marrin pjesë dhe të diskutojnë projektet të cilat janë në implementim e sipër dhe të shprehin propozimet dhe sugjerimet e tyre rreth punës dhe aktiviteteve që janë duke u zhvilluar.

Përveç projekt propozimeve të cekura më lartë, qytetarët patën mundësi të shënojnë propozimet edhe në listat e shpërndara dhe ato janë:

- Asfaltim i Rrugës së Turbis
- Ndriqimi i rrugës së Turbis
- Kanalizimi i ujërave të zeza tek shtëpia e Mullah Hysnija
- Asfaltimi i Rrugës tek Qallakët
- Vazhdimi i kanalit të ujitjes tek fidanishtja deri tek Toka e Bajram Hoxhës
- Ndërtimi i kanalit të ujitjes më një gjatësi 200 m (Bajram Krraku nuk e ka cek lokacionin)
- Ndërtimi i trotuarit dhe ndriqimit publik në lagjen Bajraktar – Gaxherr
- Vendosja e pengesave në rrugë komunale për ndaljen e shpejtësisë së automjeteve
- Themelimi i Qendrës Rinore me aktivitete të ndryshme

Pas këtyre propozimeve nuk pati ndonjë pjesëmarrës tjetër i cili dëshironte që të merrte fjalën dhe pastaj mori fjalën z.Arten Hamza dhe tha se Grupi Punues do ndjek procedurat, hartojë procesverbalin dhe raporti do ti prezentohet ekzekutivit dhe kuvendit. Gjithashtu tha se do të mbahen edhe takime tjera të grupeve të ineteresit dhe apeloj që sa më shumë qytetarë të marrin pjesë në dëgjime publike me qëllim të propozimit dhe realizimit të projekteve të cilat ndikojnë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve.

Ai mbylli takimin duke falënderuar të gjithë të pranishmit dhe përfaqësuesit e OSBE-së që na mbështesin gjithmonë.

Në këtë takim morën pjesë gjithsej 26 qytetarë prej tyre 8 të gjinisë femërore.

Procesmbajtëse:

Ariola Krasniqi

